

Lista e Çmimeve të Kredisë

Gjithçka që duhet të dini për Interesin, Kushtet dhe Sigurinë e kredisë tuaj

Kredi konsumatore në Lekë				
Shuma	Afati Minimal	Afati maksimal	Tarifë disbursimi	Norma e interesit (vjetore)
25,000 – 200,000 Lekë	6 muaj	60 muaj	2%	13% - 14.10%
200,001 - 600,000 Lekë	6 muaj	60 muaj	2%	12% - 13.05%
600,001 – 1,000,000 Lekë	6 muaj	60 muaj	1%	10.75% - 11.55%
1,000,001 – 2,000,000 Lekë	12 muaj	120 muaj	1%	10% - 10.4%
2,000,001 – 4,000,000 Lekë	12 muaj	120 muaj	1%	9% - 9.45%

Kredi konsumatore në Euro				
Shuma	Afati Minimal	Afati maksimal	Tarifë disbursimi	Norma e interesit (vjetore)
250 - 2,000 Euro	6 muaj	60 muaj	2%	13% - 14.10%
2,001 - 6,000 Euro	6 muaj	60 muaj	2%	12% - 13.05%
6,001 – 10,000 Euro	6 muaj	60 muaj	1%	10.75% - 11.55%
10,001 – 20,000 Euro	12 muaj	120 muaj	1%	10% - 10.4%
20,001 – 40,000 Euro	12 muaj	120 muaj	1%	9% - 9.45%

Normat dhe kushtet e publikuara shërbejnë vetëm për qëllime informuese. Përpara nënshkrimit të huasë, do t'ju paraqitet një pasqyrë e personalizuar e shumës së kredisë, afatit, normës fikse të interesit, NEI, këstit mujor, komisioneve, penaliteteve, planit të shlyerjes dhe shumës totale që do të paguhet.

Informacion Parakontraktor për t'ju Ndhmuar të Vendosni Para se të Aplikoni për një Kredi

Kredia Konsumatore e Bankës Jet ju ofron një mënyrë të thjeshtë dhe plotësisht digjitale për të financuar nevojat tuaja personale. Më poshtë mund të mësoni si funksionon kredia, si kryhen pagesat dhe çfarë duhet të merrni parasysh përpara se të merrni një kredi.

Për çfarë mund ta përdor Kredinë Konsumatore të Bankës Jet?

Kredinë mund ta përdorni për nevoja personale, si blerje, shpenzime familjare, udhëtime, pajisje teknologjike, arsim ose kujdes shëndetësor.

Kredia Konsumatore e Bankës Jet nuk mund të përdoret për qëllime biznesi, tregtare ose profesionale.

A është aplikimi plotësisht digjital?

Po. Mund të aplikoni, të shqyrtoni kushtet dhe të nënshkruani marrëveshjen në mënyrë digjitale.

Nuk është e nevojshme të vizitoni një degë apo të vendosni kolateral.

A kërkohet kolateral?

Jo. Për Kredinë Konsumatore të Bankës Jet nuk kërkohet pasuri e paluajtshme, depozitë apo ndonjë garanci tjetër specifike.

Miratimi varet nga të ardhurat, detyrimet ekzistuese, historiku kreditor, aftësia juaj paguese dhe kriteret e kreditimit të Bankës Jet.

A më nevojitet një llogari në Bankën Jet?

Po. Duhet të keni një llogari rrjedhëse në Bankën Jet në të njëjtën monedhë me kredinë.

Llogaria përdoret për:

- disbursimin e kredisë;
- pagesën e kësteve mujore;
- debitimin automatik të detyrimeve;
- administrimin e marrëdhënies së kredisë.

Llogaria rrjedhëse nuk ka komision hapjeje apo mirëmbajtjeje.

Në cilat monedha ofrohet kredia?

Kredia Konsumatore e Bankës Jet ofrohet në Lek dhe Euro.

Kredia, këstet mujore dhe detyrimet për shlyerjen e saj do të jenë në monedhën që zgjidhni.

Çfarë duhet të kem parasysh kur zgjedh monedhën?

Zgjedhja e së njëjtës monedhë me atë të të ardhurave tuaja zvogëlon rrezikun e kursit të këmbimit.

Përpara se të zgjidhni monedhën, vlerësoni nëse do të mund ta përballoni këstin edhe nëse kursi i këmbimit do të ndryshonte.

A është norma e interesit fikse?

Po. Kredia Konsumatore e Bankës Jet ka një normë interesi fikse.

Kjo do të thotë se norma e interesit nuk ndryshon gjatë afatit të rënë dakord dhe nuk lidhet me normat e tregut apo me indekse të jashtme reference.

Si llogariten këstet mujore?

Kredia shlyhet me këste mujore të barabarta. Çdo këst përfshin:

- një pjesë të shumës së marrë hua;
- interesin përkatës.

Përpara se të pranoni kredinë, do t'ju paraqiten shuma e kështit, afati i shlyerjes, NEI dhe shuma totale për t'u paguar.

Si paguhen kështet?

Kështet mujore debitoohen automatikisht nga llogaria juaj rrjedhëse në Bankën Jet, në të njëjtën monedhë me kredinë. Duhet të siguroheni që llogaria të ketë fonde të mjaftueshme përpara çdo datë pagese.

Si mund ta ndjek kredinë time?

Përmes aplikacionit Jet Bank mund të shikoni dhe të menaxhoni informacionin e disponueshëm për kredinë dhe lëvizjet në llogarinë tuaj.

Kontrolloni datat e ardhshme të pagesave dhe sigurohuni që llogaria e përdorur për shlyerjen e kredisë të ketë fonde të mjaftueshme.

A mund ta shlyej kredinë para afatit?

Po. Mund ta shlyeni kredinë pjesërisht ose plotësisht përpara datës së maturimit.

Në varësi të afatit të mbetur, mund të zbatohet një komision për shlyerjen para afatit. Komisioni dhe kushtet përkatëse paraqiten në Informacionin Parakontraktor dhe në marrëveshjen e kredisë.

Çfarë ndodh nëse e paguaj kështin me vonesë?

Për çdo ditë vonesë zbatohet një penalitet mbi shumën e papaguar.

Pagesa me vonesë mund:

- të rrisë detyrimin tuaj total;
- të ndikojë në historikun tuaj kreditor;
- të raportohet në Regjistrin e Kredive;
- ta bëjë më të vështirë marrjen e financimeve në të ardhmen;
- të sjellë nisjen e procedurave për mbledhjen e detyrimit.

Penaliteti dhe mënyra e llogaritjes së tij ju paraqiten përpara se të pranoni kredinë.

A mund të tërhiqem pas nënshkrimit të marrëveshjes?

Po. Mund të tërhiqeni nga marrëveshja e kredisë konsumatore brenda 14 ditëve kalendarike, pa qenë nevoja të jepni një arsye.

Detyrimet përkatëse të pagesës dhe procedura e tërheqjes shpjegohen në marrëveshjen e kredisë.

Si e vlerëson Banka Jet kërkesën time?

Banka Jet merr në konsideratë faktorë si:

- të ardhurat tuaja të verifikueshme dhe qëndrueshmërinë e tyre;
- detyrimet ekzistuese financiare;
- historikun tuaj kreditor;
- aftësinë për të përballuar kështin mujor;
- saktësinë dhe plotësinë e informacionit të dhënë;
- kriteret e kreditimit dhe të riskut të Bankës.

Paraqitja e kërkesës nuk garanton miratimin e saj. Banka Jet mund të miratojë një shumë ose afat të ndryshëm nga ai i kërkuar, ose mund ta refuzojë kërkesën.

Si nënshkruhet marrëveshja?

Marrëveshja nënshkruhet elektronikisht duke përdorur metoda të sigurta autentikimi.

Në varësi të procesit, këto mund të përfshijnë një kod OTP, PIN, të dhëna biometrike ose një metodë tjetër sigurie të miratuar. Të dhënat tuaja të autentikimit duhet t'i mbani konfidenciale dhe të mos ia ndani askujt.

Informacion i rëndësishëm

Ky Buletin i Kredisë shpjegon në mënyrë të përgjithshme si funksionon Kredia Konsumatore e Bankës Jet. Ai nuk zëvendëson Informacionin e Standardizuar Parakontraktor, marrëveshjen e kredisë, planin e shlyerjes apo dokumentacionin tjetër që ju paraqitet gjatë procesit të aplikimit.